



Për: Z. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë në detyrë
Znj. Hykmete Bajrami, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në detyrë
Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës

Nga: Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF

Lënda: Kërkesë

Datë: 30 Prill 2020

Të nderuar,

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve i cili përfaqëson 31 organizata jo qeveritare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve vlerëson veprimet e institucioneve të Kosovës në menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID – 19.

Gjatë kësaj kohe, KOMF në vazhdimësi ka monitoruar veprimet e institucioneve përgjegjëse në menaxhimin e situatës me pandeminë COVID-19, me fokus mbrojtjen e fëmijëve. KOMF vazhdimisht merr informata të besueshme nga organizatat anëtare të cilat ofrojnë shërbime direkte në terren për fëmijët e cenushtëm.

KOMF shpreh shqetësim të thellë për gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve ose kujdestarëve të tyre, e cila gjatë kohës së pandemisë është rënduar edhe më shumë.

Bazuar në nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve ose kujdestarëve të tyre, KOMF kërkon nga institucionet qeveritare që të konsiderojnë kërkesat e mëposhtme lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të sigurojmë mirëqenien e tyre gjatë përballjes me COVID-19.

KOMF kërkon:

- Qasje në informacionet dhe udhëzimet e komunikuar rreth shëndetit publik për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo nënkupton që mesazhet e transmetuara për shëndetin publik duhet të jenë gjithëpërfshirëse, duke mos diskriminuar apo stigmatizuar askënd. Gjithashtu, këto udhëzime duhet të jenë në përputhje me legjislacionin ekzistues në raste katastrofash natyrore ose në raste emergjente. Informacionet dhe udhëzimet duhet të kenë një gjuhë të qartë për t'u lexuar dhe kuptuar; Mënyrat për qasje në informacione mund të shtohen, ku përveç internetit në kohën e pandemisë mund të vihen në dispozicion edhe linjat telefonike, videot, broshurat informuese etj, si dhe interpretimi i përshtatshëm në gjuhën e shenjave. Në rastin e informimit të fëmijëve të verbër mbi epideminë, zgjidhjet alternative rreth mbrojtjes dhe kujdesit duhet të hulumtohen dhe formulohen nga vetë këta persona dhe nga organizatat që i përfaqësojnë ata.
- Investim në ofrimin e shërbimeve dhe pajisjeve të nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Është shumë e rëndësishme që gjatë kësaj kohe të eliminohet çdo pengesë financiare lidhur me qasjen në kujdesin shëndetësor për fëmijët me aftësi të kufizuara. KOMF kërkon nga institucionet përgjegjëse që të krijojnë një pako ekonomike për mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara, e cila mund të përmbajë pagesa të shumave për fëmijët me aftësi të kufizuara, ndihmë për shpenzimet specifike dhe zgjatjen automatike të çdo ndihme të marrë edhe nëse dokumentacionit të nevojshëm i ka skaduar afati. Shërbimet dhe pajisjet e domosdoshme në karantinë duhet të jenë plotësisht të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Shërbimet shëndetësore dhe ato sociale kanë

vazhdimisht mungesë të financimit të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm. Investimi në këto shërbime është thelbësor dhe urgjent për të plotësuar shpenzimet e rritura për shkak të pandemisë, përfshirë sigurimin e ilaçeve, mjeteve mbrojtëse dhe mbështetjes për stafin që punon jashtë orarit.

- Sigurim të produkteve esenciale, mbështetje profesionale gjatë ballafaqimit me pandeminë COVID-19 për fëmijët me aftësi të kufizuara. Asnjë fëmijë me aftësi të kufizuara nuk duhet të mbetet pa ushqim, mbështetje dhe shërbime profesionale të domosdoshme. Institucionet duhet të vendosin mekanizma për të autorizuar personat me aftësi të kufizuara të jenë në gjendje të dalin gjatë karantinimit të detyrueshëm, për periudha të shkurtra dhe në mënyrë të sigurt, kur përballen me vështirësi gjatë mbylljes dhe qëndrimit në shtëpi. Sigurimi i qasjes në internet (duke i liruar nga pagesa) dhe sigurimi i pajisjeve elektronike për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara duhet të bëhet, në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të mund të marrin shërbime profesionale dhe mbështetje online nga profesionistët që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Një shembull i mirë i cili mund të replikohet është Komuna e Prishtinës e cila ka zhvilluar aksionin për sigurimin e pajisjeve elektronike për fëmijët në nevojë në Komunën e Prishtinës.
- Mbështetje profesionale për prindërit/kujdestarët si dhe familjet strehuese: Kriza dhe masat e izolimit mund të përkeqësojnë shëndetin mendor dhe gjenerojnë frikë dhe ankth, prandaj mbështetja profesionale për kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara, është e rëndësishme dhe e domosdoshme.
- Organizimi i vizitave në terren, nga përfaqësuesit e institucioneve të mandatuara për të siguruar mbrojtje, për personat e identifikuar me aftësi të kufizuara që keqtrajtohen në shtëpi ose brenda komunitetit, dhe të sigurohet mbështetje adekuate për ta në mënyrë që të respektohen të drejtat e tyre njerëzore.

Duke konsideruar interesin e përbashkët që të gjithë qytetarët të gëzojnë mirëqenie sociale, KOMF kërkon vëmendjen tuaj të shtuar, në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara gjatë kohës së pandemisë COVID-19.

Sinqerisht,
Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF

KOMF, i themeluar në 2011, është koalicioni i përbërë nga 31 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Organizatave anëtare të KOMF: Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim –ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti, Nevo Koncepti, Qendra Labyrinth dhe Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmohatarë (PEN).

Kjo kërkesë u hartua në bashkëpunim edhe me organizatën Solidar Suisse, e cila është pjesë e Grupit Tematik për Shëndetësi në kuadër të KOMF.